

BULETINI

K O M U N A E V U S H T R R I S Ë

12,281,862.00€ DHE 170 PROJEKTE DO TË REALIZOHEN ME PLANIN E PROKURIMIT PËR VITIN 2024



Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka bërë të ditur se me planin e prokurimit për këtë vit do të realizohen 170 projekte në vlerën prej 12,281,862.00€, Me planin e aprovuar të prokurimit, Komuna e Vushtrrisë do zhvillojë këto aktivitet:

- 60 kontrata për furnizim në vlerën 1,416,768.00€,
- 48 kontrata për shërbime në vlerën e parashikuar prej 1,096,350.00€,
- 62 kontrata për punë në vlerën e parashikuar prej 9,668,744.00€, dhe
- Konkurset e projektimit në vlerën e parashikuar 50,000.00€.

Plani i Prokurimit për këtë vit, i cili është bërë në koordinim me drejtorinë, është hartuar duke u bazuar në buxhetin e vitit 2024, në mënyrë që ky plan të jetë konkret dhe t'i përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Kujdes i veçantë i është kushtuar kontratave afatgjate 1-3 vite, që të jenë në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunës.

SHËNOHET 25 VJETORI I RËNIES SË HEROIT XHEVAT JUSUFI

Në përvjetorin e rënies së eprorit të lartë të UÇK-së, heroit të Kosovës Xhevat Jusufi, kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, bashkë me përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësuesit e Komunës së Mitrovicës, familjarët e dëshmorit dhe qytetarë të Vushtrrisë, kanë bërë homazhe tek lapidari i heroit në fshatin Smrekonicë të Vushtrrisë. Kreu i Komunës vlerësoi lartë kontributin dhe veprën e heroit Xhevat Jusufi, për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

“Në përvjetorin e rënies së eprorit të lartë të UÇK-së, heroit të Kosovës Xhevat Jusufi, nderuam jetën dhe veprën e tij. Dëshmorët janë themeli i shtetit tonë”, tha kryetari Idrizi. Xhevat Jusufi ishte komandant për logjistikë i UÇK-së në Zonën Operative të Shalës, ai u vra më 3 Janar 1999 në Smrekonicë të Vushtrrisë.



KRYETARI IDRIZI KURORËZOI ÇIFTIN E PARË PËR VITIN 2024 NË VUSHTRRI



Kryetari Idrizi kurorëzoi çiftin e parë për vitin 2024 në Vushtrri. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka kurorëzuar sot çiftin e parë për vitin 2024 në Vushtrri.

I pari i Komunës ka lexuar deklaratën martesore dhe ka uruar çiftin e ri.

“Sot me kënaqësi lexova “Deklaratën martesore” për çiftin e ri, që shënon edhe martesën e parë për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë. Urime për dhëndrin Mirsad Krasniqi dhe nusen Agnesa Hajrizi. Çifti i ri u trashëgoftë”, tha kryetari Idrizi.



KRYETARI IDRIZI VIZITOI EKIPET KUJDESTARE

Në natën e ndërrimit të viteve, kryetari i Komunës së Vushtrrisë Ferit Idrizi, ka vizituar punëtorët shëndetësor, policët, zjarrfikësit dhe punëtorët e KRM “Uniteti”, të cilët edhe sonte janë në shërbim të qytetarëve.

“Në vizitën që ju bëmë ekipeve kujdestare, i falënderuam për punën e palodhur dhe i uruam që Viti i Ri 2024, të jetë i vit i mbarë për të gjithë. Faleminderit për përkushtimin, heronj”, tha kryetari Idrizi.

KRYETARI IDRIZI VIZITOI FAMILJEN E HEROIT AFRIM BUNJAKU



Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, bashkë me nënkryetarin Shpëtim Zhegrova, sot kanë vizituar familjen e heroit Afrim Bunjaku.

Atyre ju kanë dhënë lajmin që në vitin 2024, heroit Afrim Bunjaku do të shpallet “Nderi i qytetit”, në nderim të jetës dhe veprës së tij.

“Vizituam familjen e heroit Afrim Bunjaku, për të shprehur respektin e mirënjohjen e thellë për familjarin e tyre. Atyre ju dhamë lajmin se në vitin 2024 do t’i propozojmë Kuvendit të Komunës, që heroin Bunjaku ta shpallim “Nderi i qytetit”, tha kreu i Komunës.

Afrim Bunjaku ra heroikisht në mbrojtje të sovranitetit të Kosovës.

